



**Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs**

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA**

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE



**Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo**

Raport përfundimtar Nr. 2/2013

INSPEKTIMI I PERFORMANCËS SË NJËSIVE SPECIALE OPERATIVE (NJSO)



(Qershor 2013)

SHKURTESAT

<i>MPB</i>	<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>
<i>IPK</i>	<i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>
<i>PK -së</i>	<i>Policia e Kosovës</i>
<i>NJSO</i>	<i>Njësia Speciale Operative</i>
<i>DPPK -së</i>	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës</i>
<i>DNJS</i>	<i>Departamenti i Njësive të Specializuara</i>
<i>AKSP</i>	<i>Akademia e Kosovës për Siguri Publike</i>
<i>PSO</i>	<i>Procedurat Standarde të Operimit</i>
<i>DRP</i>	<i>Drejtoria Rajonale Policore</i>
<i>NJRSH</i>	<i>Njësitë e Reagimit të Shpejtë</i>
<i>NJSOR</i>	<i>Njësia Speciale Operative Regjionale</i>
<i>DME</i>	<i>Departamenti për Menaxhim Emergjent</i>
<i>FSK</i>	<i>Forca e Sigurisë së Kosovës</i>

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2. HYRJE

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI

3.1 Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të veprimit të Njësive të Specializuara Operative

3.2 Vlerësimi i programeve të trajnimit për operatorët, vijën e parë, të mesëm dhe të lartë menaxheriale për njësitë e specializuara

3.3 Vlerësimi i nivelit të performancës komform detyrave dhe përgjegjësi

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1 Përfundimi

4.2 Rekomandimet

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2 dhe Planin Vjetor të Inspektiveve 2013, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektiveve ka bërë një inspektim të rregullt në Njësitë Speciale Operative (NJSO) të Policisë së Kosovës (PK).

1.2. Ky inspektim u përqëndrua në kryerjen e detyrave nga Policia e Kosovës në fushën e Njësive të Specializuara, konkretisht Njësive Speciale Operative dhe u realizua nga tre Inspektorë Policor. Përveç Divizionit të Njësive të Specializuara (DNJS) të PK-së, janë vizituar edhe të gjitha komandat regjionale të NJSO-ve. Pavarësisht se është miratuar struktura e re për këto njësi, ato ende janë funksionale nëpër regjione. Reforma apo funksionalizimi do të bëhet përmes zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të pjesëtarëve të NJSO-ve, i cili tashmë numëron rreth treqind e pesëdhjetë e katër zyrtarë (354), duke e reduktuar numrin në dyqind e shtatëdhjetë e shtatë zyrtarë (277) ose në 7 togje.

1.3. Strukturimi dhe shpërndarja e këtyre njësive si dhe trajnimi i tyre është bërë në atë mënyrë që të ketë sa më shumë efikasitet për të ndërhyrë në rastet e urgjencës kur rrezikohet jeta, prona apo rendi publik i qytetarëve të Kosovës. Më datën 20.05.2012 është miratuar struktura e re e NJSO-ve dhe nga gjashtë drejtori sa kanë qenë do të mbesin vetëm një: në Prishtinë (dhe në Mitrovicë për nevoja operacionale). Ky centralizim ka për qëllim që të ketë strukturë më të thjeshtë, më praktike dhe funksionale duke i ikur komandës së dyfishtë (nga qendra dhe regjionet) si dhe ekonomizimin më të mirë të mjeteve materiale lidhur me këto njësi.

1.4. Policia e Kosovës, bazuar në strukturën organizative të saj është e ndarë në dy shtylla kryesore, në atë për Resurse dhe Operativë¹. Në këtë të fundit bënë pjesë Divizioni i Njësive të Specializuara e cila së bashku me Drejtorinë e Njësive Speciale, bartin barrën kryesore lidhur me menaxhimin, detyrat dhe operacionet me rrezikshmëri të lartë që kryejnë Njësitë e Specializuara. Me strukturën organizative në kuadër të Drejtorisë së Njësive të Specializuara hyjnë: Njësia Speciale Intervenuese (NJSI/FIT), Njësia Speciale Operative (NJSO), Njësia për Trajtimin e Materieve Eksplozuese dhe Njësia K9 (Njësia me qen). Vetë fakti që këto Njësi quhen Speciale tregon se ato kanë pajisje dhe armatim më specifik sesa pjesët tjera përbërëse të Policisë së Kosovës.

1.5. Ky personel i reduktuar do të centralizohet dhe do të koncentrohet në kuadër të DNJS-së DPP Prishtinë në një njësi të vetme në Kampin VRELLA - Prishtinë. Për nevoja operacionale një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të NJSO-së do të operoj edhe në kampin BELVEDERE - Mitrovicë. Gjatë inspektimit kemi hasur në një gatishmëri të plotë për bashkëpunim nga ana e personelit të PK-së në veçanti të NJSO-ve.

1.6. Ky inspektim i është referuar strukturës së vjetër me qëllim që të konstatohet gjendja reale dhe aktuale në të gjitha NJSO-të në nivel vendi, pasi ende janë funksionale dhe si të tilla do të jenë deri në fillim të vitit 2014 edhe pse struktura për NJSO-të është aprovuar në datën e cekur më lartë.

¹ Struktura Organizative e PK-së 2012

1.7. NJSO-të aktualisht funksionojnë në gjashtë regjione dhe ato përveç punëve të zakonshme policore kryejnë edhe të gjitha detyrat e parashtruara nga Komandat Regjionale dhe Drejtoria e Njësive Speciale e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Numri i pjesëtarëve të këtyre njësive është: 368 (përfshirë stafin menaxhues dhe stafin civil). Këtu duhet shtuar faktin se në disa regjione ka ushtrues detyre të këtyre njësive dhe ka hapësira mes gradave komanduese.

1.8. Një fushë tjetër e interesimit ishte ruajtja aktuale e armëve, municionit dhe pajisjeve të PK-së, në disa prej regjioneve të NJSO-ve, në kuptimin e sigurisë së shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. Në disa vende, sigurimi për ruajtjen e armëve dhe pajisjeve tjera ishte jo adekuat, p.sh.: në regjionin e Ferizajt, Gjilanit, Prizrenit, Pejës, armët dhe municioni ruhen (ishin të vendosura) në vende jo të përshtatshme, nuk ishin të sistemuara dhe nuk kishin një listë të saktë të inventarizimit. Rasti i Ferizajit ishte shembulli jo i mirë ku në një nga zyrat jo të përshtatshme dhe të pa sistemuar mbahen armët.

1.9. Regjioni i Prishtinës dhe i Mitrovicës kishte instaluar disa arka të metalta dhe të përshtatshme për vendosjen e armëve të cilat ishin të siguruara në mënyrë adekuate dhe procedimi, zbatimi i këtyre rregullave ishte një fakt mjaft inkurajues, ndërsa regjionet tjera nuk i kishin kushtet për sigurim të armëve dhe pajisjeve sikurse dy regjionet e lartcekura.

1.10. Praktikimi i stërvitjeve me armë zjarri dhe ushtrimeve tjera ishte jo në përputhje me PSO-të, ata ankoheshin në mungesën e sallave për ushtrime të dizajnuar për konceptin e tyre të trajnimit si dhe për mungesën e ushtrimeve ku do të përfshiheshin edhe njësi tjera për të koordinuar veprimet në mes tyre. Çështja e plotësimit të kushteve është e rregulluar edhe me PSO-të e NJSO-ve ku në kreun V neni 17.1² përcaktohen kushtet të cilat duhet të përmbushen për zhvillimin e trajnimeve të domosdoshme.

1.11. Këto njësi, nuk kanë një trajnim i cili do të vinte me një pako trajnimi që do të përfshinte një mori të gjerë fushash trajnuese, gjithmonë duke pasur në konsideratë misionet e tyre të ndërlikuara e sidomos pas miratimit të strukturës së re dhe konceptit të ballafaqimit me turma (Koncepti Kosovar), ku nga gjashtë regjione do të bëhet centralizimi i NJSO-së. Përkundrazi, ata kishin kryer trajnime të ndryshme por jo të dizajnuara me një strategji të qartë që të bëhet një koncept unik i trajnimit të NJSO-ve, sa që kjo mënyrë e rrezikonte funksionimin e tyre si ekip për shkak të ndryshimeve të shpeshta në struktura dhe në koncepte, p.sh. mungesa e qartësisë të roleve në rastet e angazhimit të dy a më shumë regjioneve në një aksion të caktuar shpesh krijon konfuzion te policët në marrjen e urdhërave. Reforma e cila është duke u zbatuar, në dukje është një fakt mjaft inkurajues që të krijohet një sistem unik i funksionimit të NJSO-së.

² Procedura Standarde e Operimit për NJSO-Trajnime, selektimi dhe ri-çertifikimi

2. HYRJE

2.1. Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, neni 24 pika 1, 2 dhe Planin Vjetor të Inspektiveve 2013, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektiveve ka bërë një Inspektim të Rregullt në Njësitë Speciale Operative të PK-së. Inspektimi u funksionalizua nga Inspektorët Policor të Departamentit të Inspektimit dhe është zhvilluar nga data 29 prill deri me datën 15 maj të këtij viti sipas planit operativ të aprovuar.

2.2. Qëllimi i këtij inspektimi është që të vlerësohet niveli i performancës së Njësive të Specializuara Operative lidhur me përgatitjen e tyre profesionale, mbi detyrat dhe përgjegjësitë menaxheriale për udhëheqjen e këtyre njësive të specializuara si dhe rezultatet e punës së tyre.

2.3. Qëllim tjetër i këtij inspektimi është që të bëhen rekomandime se si menaxherët e lartë të NJSO-së do të mund të përmirësonin paraqitjen në menaxhimin e trajnimeve në përdorimin e armëve të zjarrit dhe performancës konform detyrave dhe përgjegjësie.

2.4. Objektivi që synon të arrij ky inspektim është:

- Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të veprimit të Njësive të Specializuara Operative
- Vlerësimi i programeve të trajnimit për operatorët, vijën e parë, të mesëm dhe të lartë menaxheriale për njësitë e specializuara
- Vlerësimi i nivelit të performancës konform detyrave dhe përgjegjësie

2.5. Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji i Policisë së Kosovës
- Legjislacioni (Udhëzimet Administrative-Rregulloret) lidhur me NJSO-të
- Procedurat Standarde të Operimit të NJSO-ve
- Një tabelë në hollësi të organizimit për NJSO-të
- Të dhënat statistikore (formulari i përmbledhur), mbi aktivitetin e NJSO-ve
- Hollësitë në lidhje me ndërtimin-trajnimin e kuadrove të NJSO-ve (2011-2012)
- Planin Vjetor i NJSO-ve të PK-së për 2013
- Raportin Vjetor i NJSO-ve të PK-së për 2012
- Kontrollimi i Turmave (Koncepti Kosovar)
- Intervistat me akterët relevant

2.6. Duke pasur parasysh natyrën e detyrave dhe përgjegjësie si dhe pajisjet që kanë në dispozicion NJSO-të, këto të fundit janë të gjykuara nga përceptimi i publikut të jenë në dukje më problematike sesa njësitet tjera të sigurisë publike. Por, ky përceptim qytetar mund të balancohet dhe ndryshohet duke inspektuar (NJSO-të nga IPK) dhe duke sjellë argumente se disa probleme që mund të rrjedhin nga praktikat aktuale të NJSO-ve mund të rivlerësohen, modifikohen dhe të përdoren praktikat më të mira për funksionimin e tyre.

2.7. Ky inspektim është zhvilluar me metodën e intervistimit, marrjes së dokumentacionit relevant në bazë të të cilit punojnë NJSO-të, raportet nga NJSO-të regjionale, analizimin dhe vlerësimin e tyre, inspektime në terren si dhe intervistimi i pjesëtarëve të NJSO-ve.

2.8. Gjatë rrjedhës së inspektimit, Inspektorët Policor kanë intervistuar:

- Drejtorin e Divizionit të Njësive të Specializuara
- Drejtorin e NJSO-ve
- Komandantin e NJSO-Prishtinë
- Shefi i Operativës-Prishtinë
- Komandantin e NJSO-Mitrovicë
- Shefi i Operativës-Mitrovicë
- Komandantin e NJSO-Pejë
- Komandantin e NJSO-Prizren
- Komandantin e NJSO-Ferizaj
- Komandantin e NJSO-Gjilan
- Policë rasti nëpër NJSO-të rajonale

3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE NË PËRGJITHËSI

3.1. Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të veprimit të NJSO-ve

3.1.1. Njësia Speciale Operative (NJSO) është njësi e specializuar policore në kuadër të Drejtorisë së Njësive Speciale të Policisë së Kosovës e cila është përgjegjëse për të siguruar rend dhe qetësi publike, të ofrojë mbështetje dhe përkrahje operative të gjitha njësive tjera policore. Pjesëtarët e saj kryejnë të gjitha detyrat e policisë të përcaktuara me ligj siç janë: ruajtja e jetës dhe pasurisë së qytetarëve, mbrojtja e rendit publik, sigurimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve, sigurimi dhe menaxhimi me tubime publike, operacione të planifikuara si dhe detyra tjera siç përcakton Ligji për Policinë.

3.1.2. Detyrë dhe përgjegjësi kryesore të NJSO-ve janë: përballja me trazirat qytetare, sigurimin e tubimeve publike, arrestimin e personave të konsideruar si të rrezikshëm, bastisje, sigurimi i ndërtesave të organeve të drejtësisë, përcjelljen e personave të dyshimtë me rrezikshmëri të mesme dhe të lartë, asistencë njësive tjera të specializuara për përcjelljen e personave VIP vendor dhe ndërkombëtarë, përcjellja e transportimit të materialeve të rrezikshme si njësi përkrahëse, mbështetjen e drejtorive rajonale në punët e tyre ku njësitë tjera dështojnë në kryerjen e atyre detyrave, etj.

3.1.3. NJSO-të aktualisht veprojnë në bazë të Procedurës Standarde të Operimit³ e aprovuar nga Ndihmës Drejtori i Përgjithshëm për Operativë, DPP Prishtinë e cila ka hyrë në fuqi më dt. 11.11.2011. Kjo PSO tregon organizimin e përgjithshëm të njësive të specializuara si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të NJSO-ve. Mirëpo, përveç kësaj që cekëm më lartë, organizimi dhe reformimi i NJSO-ve parashihet me një dokument për reformimin dhe riorganizimin e Njësive Speciale gjë që krijon një dualizëm të organizimit aktual të NJSO-ve, për shkak se PSO-ja e cekur më lartë ende është në fuqi.

Rekomandimi nr. 1

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që Divizioni i Njësive Speciale duhet të rishikoj PSO-në në fuqi që rregullon punën e NJSO-ve dhe ta harmonizoj me aktet ligjore në fuqi dhe ndryshimet organizative-strukturore që janë aprovuar për NJSO-të më datën 20.05.2012.

3.1.4. Me reformën dhe riorganizimin, NJSO-të kanë filluar më 20.05.2012 ku edhe gjatë periudhës sa ne kemi inspektuar kjo njësi ende është duke u reformuar dhe sipas menaxherëve të lartë të këtij divizioni struktura do bëhet funksionale në fillim të vitit 2014. NJSO-ja në bazë të reformës do të ketë 277 pjesëtarë, përfshirë edhe strukturën komanduese. IPK vlerëson se reforma dhe riorganizimi i NJSO-ve është duke ecur me ritme të ngadalshme dhe gjatë kësaj periudhe udhëheqja, mbikëqyrja dhe menaxhimi ishte i vështirësuar, por nuk e prek në thelb funksionimin operativ të NJSO-ve. Reforma dhe riorganizimi i zgjatur kishte krijuar një jo qëndrueshmëri në unifikimin e komandës, ngritjen e efikasitetit, zvogëlimin e burimeve njerëzore dhe demotivimin e tyre.

³ PSO nr. reference DPP/DNJS/NJSO/001/10

3.1.5. Dokument tjetër i rëndësishëm për NJSO-të është “Koncepti për Ballafaqim me Turmat” të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i PK-së më 14.02.2011. Ky dokument është unik dhe i një rëndësie të veçantë për shkak se NJSO-të, duke filluar që nga viti 2002 e tutje janë trajnuar sipas disa modeleve për ballafaqim me turma, duke filluar nga ai: Irlandez, Britanik, Danez, MSU Italian, etj.

3.1.6. Deri më tani NJSO-të kanë pasur komandë të dyfishtë (ende është faktike) dhe si pasojë kanë ndodhur edhe paqartësi të ndryshme në aspektin e angazhimeve dhe të ndarjes së kompetencave në mes të drejtorive regjionale dhe Divizionit të NJSO-ve.

3.1.7. Ndryshimi i shpeshtë i strukturave organizative të PK-së ka prekur edhe NJSO-të, me ç’rast vendet udhëheqëse në NJSO nuk janë përmbushur me gradat e duhura për vendin e duhur. Kjo mungesë e gradave për vendet udhëheqëse është evidente në të gjitha NJSO-të në nivel vendi. Sipas PSO-së me të cilën veprohet Komandanti i NJSO-së duhet të ketë gradën e Majorit ose Kapitenit. Përveç Prishtinës që ka komandantin me gradën e Kapitenit, asnjë njësi tjetër në regjionet aktuale nuk ka gradën e duhur, përkundrazi, ka U. D. Komandantit me gradën rreshter ose toger. (Shih tabelën nr. 1)

Rekomandimi nr. 2

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që procesi i stabilizimit të strukturës së menaxhimit brenda NJSO-së duhet të përshpejtohet, dhe në këtë mënyrë të evitohen diferencat e mëdha në menaxhmentin e NJSO-së lidhur me shtrirjen e kontrollit dhe plotësimin e pozitive me grada adekuate.

3.1.8. IPK-ja vlerëson se edhe pas ristrukturimit të NJSO-ve të ketë kujdes në përshkrimin e qartë për vendet e punës, sidomos të gradave të larta menaxheriale dhe të vendosen personat me grada adekuate për vendin e punës që i përgjigjet asaj grade.

3.1.9. Numri i përgjithshëm i pjesëtarëve të NJSO-ve për vitin 2012 sipas raportit vjetor të DNJS-se, ishte 368. Shpërndarja e këtij personeli në bazë të gradave është si në vijim: (Shih tabelën nr.1)

Personeli sipas gradave	Periudha aktuale e raportimit për vitin 2012	DNJS	NJSO-Prishtinë	NJSO - Mitrovicë	NJSO - Pejë	NJSO - Prizren	NJSO - Gjilan	NJSO - Ferizaj
Major	1	1						
Kapiten	3	2	1					
Toger	4			2		1	1	
Rreshter	29	2	7	3	5	6	3	3
Polic	325	1	98	88	59	36	22	21
Staf Civil	6	2	2	2				
Gjithsejtë	368	8	108	95	64	43	26	24

3.1.10. Në bazë të strukturës organizative funksionale për vitin 2012, numri i përgjithshëm i stafit nëpër DRP dhe në përgjithësi në NJSO, asnjëherë nuk ka qenë i plotësuar apo funksional sipas strukturës që ka qenë në fuqi, ku kanë qenë të paraparë 448 (aktualisht 368) personel (staf i uniformuar) si pjesë përbërëse e NJSO-ve në gjashtë regjione.

3.1.11. Sa i përket rekrutimit të pjesëtarëve të NJSO-ve, që aktualisht veç është duke ndodhur në tërë regjionet, IPK-ja ka gjetur se rekrutimi dhe zgjedhja e këtyre pjesëtarëve është duke u bërë i njëjtë si për ata që kanë qenë pjesë e njësive speciale, ashtu edhe për personat që nuk kanë punuar në këto njësi.

3.1.12. IPK-ja gjatë inspektimit ka marrë opinione të ndryshme nga operatorët e NJSO-ve pavarësisht se në dukje të parë kjo paraqet barabarësi dhe mundësi që të gjithë të konkurrojnë. Pakënaqësia e operatorëve ka bërë që shumë pjesëtarë të NJSO-ve në regjione të mos kenë interesim për këtë reformë me arsyetimin se procesi ka qenë i ngutshëm dhe se nuk e kanë marrë për bazë punën e bërë deri më tani. Përveç kësaj, nga biseda me pjesëtarët e NJSO-ve, sidomos në Pejë, ata theksojnë se me këtë proces është bërë diskriminim ndaj tyre për zgjedhjen se a do të konkurrojnë në Prishtinë apo Mitrovicë. Lidhur me këtë i'u është thënë se mund të konkurrojnë vetëm në NJSO Mitrovicë. Këto opinione apo konstatime nga operatorët nuk janë dëshmuar në formë të shkruar apo me ndonjë dokument zyrtar që vërtetë ka ndodhur një gjë e tillë.

3.1.13. Duke marrë për bazë natyrën e punës së NJSO-ve ekzistojnë disa kritere bazë pa të cilat një person nuk mund të jetë pjesë e tyre, e ndër to veçohen: shëndeti i mirë, si ai fizik ashtu edhe ai psikik, aftësia për t'u përballur me detyra të natyrës së veçantë dhe të rrezikshme, si dhe të ketë së paku dy vite përvojë pune në Policinë e Kosovës. Lidhur me këto, kandidatët duhet t'iu nënshtrohen: testit fizik, verbal dhe hetimin e së kaluarës së tyre.

3.1.14. Procesi i pranimit të kandidatëve në NJSO në bazë të reformës vlerësohen të jenë të domosdoshme, në mënyrë që të shihen aftësitë e tyre fizike e psikike dhe të zgjidhen ata që vërtetë kanë kualitete dhe qëndrueshmëri në zbatimin e detyrave që dalin për këtë njësi policore. Në këtë pikë IPK-ja vlerëson përpjekjet serioze të DNJS-së që këto kritere të zbatohen me përpikëri me PSO-të. Gjatë vlerësimit të kriterëve të përcaktuara në konkurs që aktualisht është duke u zbatuar, IPK-ja konstaton se kriteret e konkursit janë në përputhje të plotë me standardet dhe rregullat e përcaktuara nga PK-ja.

3.1.15. Reforma e NJSO-ve parasheh që pjesëtarët e saj të cilët nuk do të jenë pjesë e NJSO-ve në bazë të konkursit, të kalojnë (sistemohen) në Njësitet e Reagimit të Shpejtë (NJRSH) në gjashtë regjione. Funksionimi i NJRSH-ve në kuadër të të gjitha DRP-ve do të rregullohet nga Departamenti për Siguri Publike i cili do të vendosë sistemimin dhe nxjerrjen e PSO-ve (për NJRSH) bashkarisht me Drejtoritë Rajonale. DRP-të janë përgjegjëse për menaxhimin e NJRSH-ve dhe planifikimin buxhetor për këto njësi.

3.1.16. Pjesëtarët e NJRSH-ve do të konsiderohen togje rezervë të NJSO-ve ku DNJS-ja do të kujdeset vetëm për rifresikimin e njohurive apo aplikimin e teknikave të reja trajnuese nëse eventualisht modifikohet koncepti i punës. Gjatë kohës së inspektimit ne kemi vërejtur mungesë qartësimi rreth kësaj sepse krahas reformës për NJSO-të, paralel duhet të bëhet edhe themelimi i NJRSH-ve, të përgatiten PSO-të për këto njësi dhe tranzicioni apo reforma mos t'i

kaloj limitet kohore që do ta vështirësonin kryerjen e detyrave nga këta pjesëtarë që do jenë pjesë e NJRSH-ve.

3.1.17. IPK-ja gjatë inspektimit nuk ka hasur në asnjë dokument që precizon punën e NJRSH-ve nëpër regjione për të ardhmen, përveç dokumentit të reformës për NJSO-të, i cili paraqet vetëm shifrën për distribuimin e kapaciteteve të zyrtarëve policor të ndarë në gjashtë regjione ku parashihet si në vijim: DRP-Prishtinë do të ketë kapacitet operativ 30 zyrtarë policor (përfshirë edhe stafi komandues), DRP-Mitrovicë 80 zyrtarë policor, DRP-Pejë 30 zyrtarë policor, DRP-Prizren 30 zyrtarë policor, DRP-Gjilan 15 zyrtarë policor, DRP-Ferizaj 15 zyrtarë policor⁴.

Rekomandimi nr. 3

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin policor që gjatë implementimit të reformës për NJSO-të të angazhohet edhe për formimin e NJRSH-ve jo vetëm në aspektin strukturor por edhe atë praktik duke u përcjellur me aktet e nevojshme rregullative.

3.1.18. Mungesa e palestrave sportive për të mbajtur lartë nivelin e përgatitjes fizike të zyrtarëve policor, komunikimi jo i mirë në mes njërive regjionale dhe qartësimi i kompetencave, janë vetëm disa nga treguesit të cilët ndikojnë që përgatitja fizike, shkathtësitë psikologjike, motivimi dhe vendimmarrja tek zyrtarët policor të NJSO-ve, të mos jenë në nivel të kënaqshëm.

3.1.19. Praktikimi i stërvitjeve me armë zjarri dhe ushtrimeve tjera ishte jo në përputhje me PSO-të. Ata ankoheshin në mungesën e sallave për ushtrime të dizajnuar për konceptin e tyre të trajnimit si dhe për mungesën e ushtrimeve ku do të përfshiheshin edhe njësi tjera për të koordinuar veprimet në mes tyre. Çështja e plotësimit të kushteve është e rregulluar edhe me PSO-në për NJSO-të ku në kreun e V neni 17.1 përcakton kushtet të cilat duhet të përmbushen për zhvillimin e trajnimeve të domosdoshme.

3.1.20. NJSO-të Pejë, Gjilan, Ferizaj, Prizren edhe pse posedonin një arsenal mjaft të pasur të pajisjeve dhe armëve të zjarrit, certifikimet e tyre ishin të kufizuara dhe në papajtueshmëri me nenin 17.3 të PSO-së për NJSO-të⁵. Hapësira ku ata ishin vendosur nuk ishte e përshtatshme, nuk kishte kushtet e nevojshme për të mbajtur kondicionin fizik dhe mendor. Mungojnë sallat për ushtrime fizike, hapësirat për pushim dhe qëndrim ditë dhe objektet ku janë të vendosura janë të pa përshtatshme, komponente këto të cilat janë vendimtare në marrjen e vendimeve ashtu siç e kërkon edhe detyra e tyre.

3.1.21. IPK-ja gjatë inspektimit konstatoi se përkrahja shëndetësore nuk aplikohet sipas parimeve dhe procedurave për pjesëtarët e NJSO-ve (neni 15), ku këtu hyjnë testet mjekësore dhe psikologjike periodike, sigurimi shëndetësor për operatorët në rast lëndimi në detyra të rrezikshme. Ky sigurim shëndetësor sipas nenit 15, pika C të PSO-së për NJSO, nuk përfshinë sigurimet e përgjithshme shëndetësore (i cili nuk aplikohet) me të cilin mund të jenë të siguruar të gjithë pjesëtarët e PK-së, por ky është një lloj sigurimi vetëm për NJSO-të.

⁴ Draft Dokumenti për reformimin dhe riorganizimin e NJSO-ve

⁵ Trajnimet Periodike në gjuajtje me armë zjarri

Rekomandimi nr. 4

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, fuqishëm menaxhmentin e PK-së që të filloj aplikimin e parimeve dhe procedurave të sigurimit shëndetësor për pjesëtarët e Njësiwe Speciale konform (PSO, ne. 15) krijimin e kushteve të cilat duhet të përmbushen për zhvillimin e trajnimeve të domosdoshme (PSO, ne. 17.1).

3.1.22. Inspektorët Policor në disa regjione (Gjilan, Pejë, Prizren, Ferizaj) kanë vërejtur shqetësimin e policëve lidhur me sigurimin e ushqimit. Ata kanë potencuar se janë të diskriminuar dhe jo të barabartë me kolegët e tyre që punojnë në regionin e Prishtinës dhe të Mitrovicës edhe pse detyrat dhe përgjegjësitë i kanë të njëjta. Inspektorët Policor janë interesuar pse ndodh ky diskriminim dhe ka konstatuar se çështja është te vendimmarrja e jo të pamundësia e mos përfshirjes edhe të këtyre regjioneve në sigurimin e ushqimit. Në kuadër të Policisë së Kosovës ekziston një kontratë kornizë për shërbime (pije, ushqim, etj.) dhe kjo kontratë është e dizajnuar varësisht nga porosia dhe çmimi për njësi (ushqim), gjë që një vendim nga struktura kompetente (drejtori i DNJS-së) do të evitonte këtë pabarazi derisa këto njësi janë funksionale.

3.1.23. Është me rëndësi të theksojmë se në momentin e funksionalizimit të inspektimit nga IPK-ja, DNJS-ja në konsultim të ngushtë me Inspektorët Policor, ka marrë hapa konkret në disa fusha konkrete, ku më e rëndësishmja është inventarizimi në të gjitha Njësitë Speciale Operative Regjionale dhe ky veprim i menjëhershëm është hap mjaftë inkurajues e sidomos tani kur NJSO-ja është duke kaluar fazën e riformimit dhe riorganizimit nga gjashtë regjione në një njësi unike.

3.2. Vlerësimi i programeve të trajnimeve

3.2.1. Trajnimet e zyrtarëve policor nga NJSO-ja luajnë rol shumë të rëndësishëm në aftësimin dhe edukimin e vazhdueshëm të tyre duke ndikuar në formimin e etikës dhe profesionalizmit të punës që kryejnë konform përgjegjësiwe ligjore që i zbaton Policia e Kosovës. NJSO-të përveç detyrave të tyre të përditshme që i kanë, angazhohen edhe në trajnime të rregullta ditore, javore, mujore dhe vjetore.

3.2.2. Të gjitha trajnimet që i kryejnë personeli i NJSO-së janë të natyrës së punës dhe brenda kornizës ligjore si të Ligjit të PK-së ashtu dhe Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të PK-së. Kjo obligon dhe paraqet nevojën, që në kuadër të stafit të ketë njerëz profesional, njohës të mirë të praktikave policore si dhe pedagogë të mirëfilltë në dhënien e njohurive mbi punën e Njësiwe Speciale.

3.2.3. Nga intervistat me pjestarët e NJSO-së kuptuam se progresi i vijuesve të trajnimeve rrallë herë vlerësohet me organizim të testeve. Ky nuk është shembull i mirë. Ligjëruesit në disa kurse kur e shohin të nevojshme përgatisin teste me shkrim e në disa raste fare nuk bëjnë një gjë të tillë. Gjatë kurseve më shumë praktikohet që në fund të zhvillohen anketa mbi perceptimet e vijuesve mbi trajnimet lidhur me trajnerët, etj. Sikur të përdoren testet e vlerësimit atëherë vijuesit do ta kenë të qartë se do të vlerësohen në mënyrë që të jenë më aktiv gjatë mbajtjes së kurseve.

Rekomandimi nr. 5

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që aftësitë dhe njohuritë individuale të fituara gjatë trajnimit, të vlerësohen përmes testeve standarde, në drejtim të rritjes së efikasitetit të performancës së NJSO-së.

3.2.4. Gjatë intervistave të personelit të NJSO-së, IPK-ja konstaton se, trajnerët duhet pasur kujdes në mbajtjen e kontinuitetit të planeve dhe programeve mësimore, duke përcjellë ndyshimet që i miraton Divizioni i Trajnimeve, trendet e zhvillimit të policive bashkëkohore dhe kështu këto ndryshime të futen në procesin e mësimdhënies. Nga pohimet e pjesëtarëve të NJSO-së është vërejtur një dukuri e mosinteresimit të policëve për vijimin e trajnimeve ditore dhe këtë e arsyejnë me rënien e nivelit profesional të instruktorëve që duhet të testohen kohë pas kohe ashtu siç e përcakton PSO-ja. Kjo ndikon në demotivim të pjesëtarëve të NJSO-së për pjesëmarrje në këto trajnime për shkak se ata nuk i kanë parasysh pjesëmarrësit që i kanë kurset e kryera në të kaluarën si dhe u mungon një komunikim i mirëfilltë.

3.2.5. Sipas PSO-së, Komandanti i NJSO-së i mbikëqyrë dhe administron trajnimet në njësi përmes zyrës së trajnimeve. Po ashtu, pjesëtarët e NJSO-ve duhet të kenë trajnime të përbashkëta me njësitë tjera speciale të Policisë së Kosovës si dhe me organizata të tjera të sigurisë siç janë: Zjarrëfikësit, EULEX-it, KFOR, etj., për të qenë të përgatitur për operacionet e kërkim shpëtimit dhe fatkeqësitë natyrore.

3.2.6. Divizioni i Trajnimeve përveç trajnimeve të cilat i organizon vet brenda dhe jashtë vendit për NJSO-të, organizon edhe trajnime në bashkëpunim me organizata të tjera (EULEX-it, KFOR, ICITAP, etj.) të cilat veprojnë në Kosovë. Kryesisht këto trajnime organizohen mbi bazën e analizimit të nevojave për trajnime për të cilat Divizioni i Trajnimeve dhe DNJS-ja konsideron se nuk kanë kapacitete të ndërhuara për zhvillimin dhe mbajtjen e tyre (është fjala për trajnime të specializura). Në këto trajnime përdoren metoda teorike dhe praktike të zhvillimit të trajnimeve, nga kontribues të brendshëm dhe të jashtëm. Derisa kontribues të brendshëm janë trajnerët vendorë, kontribues të jashtëm mund të jenë konsulentë si prokurorë, profesorë universitarë, etj.

3.2.7. Në vijim po ju paraqesim pasqyrën tabelore nga raporti vjetor 2012 nga Divizioni i Trajnimeve për trajnimet e realizuara për NJSO-të gjatë vitit 2012.⁶ (tabela nr. 2)

Tabela nr. 2 Raporti vjetor i Divizionit të Trajnimeve për trajnimet e realizuara për NJSO-të për vitin 2012		
	Kurset	Pjesëmarrës
Trajnime të përgjithshme nga Divizioni i Trajnimeve/AKSP	20	315
Trajnime nga organizata të huaja	11	253
Trajnime jashtë vendit	4	17
Gjithsejtë	35	585

⁶ Raporti vjetor i Divizionit të Trajnimeve, DPP Prishtinë - për trajnimet e realizuara për NJSO-të për vitin 2012.

3.2.8. IPK-ja gjatë inspektimit në Divizionin e Trajnimeve në raportin e inspektimit do të prezantojmë informacione nga Raporti Vjetor i trajnimeve për NJSO-të gjatë vitit 2012. Sipas Raportit Vjetor 2012 për të gjitha NJSO-të rajonale nga Divizioni i Trajnimeve janë realizuar trajnime të ndryshme si: trajnime të përgjithshme në nivel vendi të organizuara nga Divizioni i Trajnimeve dhe AKSP janë realizuar gjithsejtë 20 kurse dhe janë trajnuar gjithsejtë 315 pjesëtarë të NJSO-ve. Në trajnimet e organizuara nga organizata të tjera (huaja) janë realizuar gjithsejtë 11 kurse dhe janë trajnuar gjithsejtë 253 pjesëtarë të NJSO-ve, ndërsa trajnimet e mbajtura jashtë vendit janë gjithsejtë 4 kurse dhe janë trajnuar gjithsejtë 17 pjesëtarë të NJSO-ve. Gjatë këtij intervali kohor janë realizuar gjithsejtë 35 kurse dhe janë trajnuar gjithsejtë 585 pjesëtarë të NJSO-ve.

3.2.09 Tabela nr. 3 Statistikat vjetore të NJSO-ve Rajonale për kurset obligative, gjatë vitit 2012.

Tabela nr. 3 Statistikat vjetore të NJSO-ve Rajonale për kurset e kryera obligative, gjatë vitit 2012							
	NJSO Prishtinë	NJSO Mitrovicë	NJSO Pejë	NJSO Prizren	NJSO Gjilan	NJSO Ferizaj	Raportet e NJSO -ve Rajonale Nr. total i personelit të trajnuar
Kursi i Ri-çertifikimit	0	0	60	0	15	8	83
Kursi i Ri-çertifikimit për armë zjarri (MP-5, AK-47, UMP, G-36 dhe Shot Gun)	0	0	69	59	1	89	218
Gjithsejtë	0	0	129	59	16	97	301

3.2.10. Sipas statistikave vjetore të NJSO-ve Rajonale veçojmë kurset obligative si Kursin për Ri-çertifikim dhe Kurset për armë zjarri (MP-5, AK-47, UMP, G-36 dhe Shot Gun). Bazuar nga statistikat vjetore për vitin 2012 të NJSO-ve Rajonale, Kursin e Ri-çertifikimit nga numri total i pjesëtarëve të NJSO-ve me gjithsejtë 356 personel i uniformuar, gjatë këtij viti janë trajnuar gjithsejtë 83 pjesëtarë të NJSO-së, çka d.m.th. se vetëm 23% e këtyre pjesëtarëve janë ri-çertifikuar, dhe se 77% e tyre kanë mbetur akoma pa e kryer kursin në fjalë. Ndërsa, kurset për armë zjarri (MP-5, AK-47, UMP, G-36 dhe Shot Gun), sipas statistikave vjetore 2012 të NJSO-ve Rajonale del se nga numri total i pjesëtarëve të NJSO-së me gjithsejtë 356 personel i uniformuar gjatë këtij viti e kanë të kryer vetëm 218 pjesëtarë të NJSO-së, çka nënkuptojmë se vetëm 61% e këtyre pjesëtarëve janë të ri-çertifikuar dhe se kanë mbetur edhe 39% e tyre të pa ri-çertifikuar për armë të gjata.

Rekomandimi nr. 6

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin e DNJS-së, të organizojë dhe mbajë trajnime për ri-çertifikim të rregullt të trajnerëve, ri-çertifikim sipas Parimit 8.14 si dhe rregullave të parapara për ri-çertifikim me armë të gjata.

3.2.11. Sipas PSO-së për "Trajnimet periodike në gjuajtje me armë zjarri" NJSO-të duhet të kenë municion të mjaftueshëm (kalibër 9mm) për trajnime brenda njësisë dhe testimet e rregullta 3 mujore për policët e vet, me nga 800 fishekë. Së paku dy herë në vit kalendarik zyrtarët policor

të NJSO-së, duhet të kryejnë trajnime njëditore me të gjitha armët zyrtare që i posedon njësia. Në këtë drejtim DNJS-ja nuk ka arritur të implementoj këtë obligim gjatë vitit 2012 (Siç shihet në tabelën nr. 3.)

3.2.12. Sipas PSO-së Testet periodike për pjesëtarët e NJSO-së (Ri-çertifikimi brenda njësisë) dhe organizmi i tyre duhet të bëhet me urdhër të komandantit të NJSO-së. Testet e rregullta periodike për pjesëtarët e NJSO-së duhet të mbahen çdo gjashtë muaj, në tremujorin e parë dhe në tremujorin e fundit të çdo viti kalendarik. Testet e rregullta periodike për pjesëtarët e NJSO-së duhet të zgjasin 2 ditë.

Rekomandimi nr. 7

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, Drejtorin e Divizionit të Njësisë të Specializuar edhe pse deri në fund të vitit 2014 pritet që të centralizohet kjo njësi (NJSO) vetëm në një strukturë unike, që në të ardhmen kurseve obligative dhe të avancuara t'u jipet prioritet në mënyrë që i gjithë personeli i NJSO-së të trajnohen.

3.2.13. IPK -ja gjatë inspektimit gjithashtu ka marrur edhe planprogramin e kursit Ballafaqimi me Turma sipas Konceptit Kosovar, me qëllim të analizimit të saj në përbërjen e aktiviteteve gjatë trajnimit, përbrenda programit konform praktikave operative që zyrtarët policor të NJSO-së i kryejnë në teren. Afati kohor për trajnimin e zyrtarëve policor të NJSO-së në këtë kurs është që në teori duhet mbajtur 36 orë, në praktikë 69 orë me një total prej 105 orë dhe është obligative për çdo zyrtar të NJSO-së.

3.2.14. Qëllimi i këtij trajnimi "Ballafaqimi me turma" është përgaditja e pjesëtarëve të NJSO-së me njohuritë bazë për ballafaqim me turma, gjithashtu shtjellimi i të gjitha teknikave të parapara me Konceptin Kosovar për ballafaqim me turma. Trajnimin ballafaqimin me turma e kanë ndjekur të gjithë pjesëtarët e NJSO-ve në nivel të Republikës së Kosovës (është kryer nga 356 pjesëtarë). (Tabela nr. 4 paraqet përmbajtjen e konceptit kosovar për ballafaqim me turma)

3.2.15. IPK-ja nga Divizioni i Trajnimeve ka siguruar planprogramin e një seminari një javor për NJSO-të, me të cilin shtjellohen disa nga temat që përkohë me punën e operatorëve në praktikë. Qëllimi i këtij seminari është rifreskimi i njohurive për pjesëtarët e NJSO-së, në këto fusha:

- ✓ të drejtat e njeriut,
- ✓ përdorimi i forcës,
- ✓ procedurat e arrestimit,
- ✓ përsëritja e kontrollit të butë dhe të fortë duarthatë,
- ✓ përdorimin e shufrës, dhe
- ✓ arrestimet gjatë kontrollimit të turmave.

3.2.16. IPK konsideron që aktivitetet (seminaret) e tilla në të ardhmen të jenë më të shpeshta, me qëllim që pjesëtarëve të NJSO-ve t'u ofrohet një mundësi praktike e zbatimit të procedurave në përputhshmëri me standardet e përcaktuara nga vet PK-ja. Llojet e tilla të seminareve kanë dhënë rezultat pozitiv, në kryerjen e detyrave nga pjesëtarët e NJSO-ve. Ky fakt është vërejtur

edhe nga Inspektorët Policor gjatë periudhës së inspektimit, e posaçërisht përdorimi i formularit të veçantë (i NJSO-ve) për arrestim është mjaft domethënës.

Tabela nr. 4 Emri i Trajnimit: Ballafaqimi me turma⁷
Aktivitetet gjatë trajnimit

Nr.	Njësitë Mësimore	Teori orët	Praktikë orët	Nr. i orëve
1	Prezantimi i aktiviteteve të trajnimit	½	-	½
2	Historiku i Njësive Speciale	½	-	½
3	Baza ligjore	½	-	½
4	Kodi i mirësjelljes	½	-	½
5	Etika	1	-	1
6	Përgaditja psikologjike	1	-	1
7	Psikologjia e turmës	1	-	1
8	Paisjet	1	1	2
9	Shenjat taktike	1	1	2
10	Kontrollimi i turmave të qeta	1	2	3
11	Togu formacioni detyrat	3	4	7
12	Rreshtimi, inspektimi dhe pozitat	1	1	2
13	Teknikat bazë	3	5	8
14	Formacioni breshkë, Formacioni mbulesë	3	5	8
15	Polici i lënduar	1	2	3
16	Arrestimi	1	2	3
17	Fikja e zjarrit, Largimi i barrikadave	2	5	7
18	Marrja e udhëkryqeve	1	5	6
19	Përcjellja e afërt e detyruar pyka dhe hinka	1	2	3
20	Manifestimet kulturore dhe sportive	1	-	1
21	Lirimi i objekteve dhe sigurimi i tyre	1	2	3
22	Vendosja e maskës	1	1	2
23	Gazi lotësjellës	1	1	2
24	K9	1	1	2
25	Përdorimi i automjeteve	2	4	6
26	Përdorimi i automjeteve të blinduara	1	2	3
27	Përdorimi i topit të ujit	1	2	3
28	Kontrolli i butë duarthatë, shufra	1	3	4
29	Edukata fizike	-	12	12
30	Testi fizik	-	1	1
31	Përsëritja e temave të kursit (testimi i njohurive të fituara)	1	-	1
32	Prezantimi final	-	2	2
33	Vlersimi i kursit	1	-	1
34	Diplomimi (ndarja e çertifikatave)	-	2	2
Totali i orëve		36	69	105

⁷ Tabela për kursin Ballafaqim me turma, marrë nga Divizioni i Trajnimeve, DPP Prishtinë

3.3 Vlerësimi i nivelit të performancës konform detyrave dhe përgjegjësi

3.3.1. Gjatë inspektimit një vëmendje i është kushtuar edhe performancës së NJSO-ve, pasi performanca paraqet gjendjen kryesore se si një organizatë ka udhëhequr proceset e punës dhe të arriturat në bazë të objektivave që i ka caktuar ligji. Performanca është proces i vlerësimit me qëllim që të konstatohet një gjendje reale për efikasitetin dhe kualitetin e kryerjes së detyrave ashtu si parasheh ligji.

3.3.2. NJSO-të gjatë punës së tyre i kanë përcjellë debate të shumta nga akterë të ndryshëm për sjelljet e saja në publik, të cilat i kanë cilësuar si të pa përshtatshme dhe përdorim të panevojshëm të forcës. Në këtë drejtim edhe pse është mbajtur një seminar lidhur me këtë fushë, DNJS-ja duhet që pjesëtarët e vetë sa më shpesh t'i testojë dhe vlerësojë lidhur me këtë fushë dhe ngritjen e disiplinës gjatë angazhimit të tyre në raport me qytetarët.

3.3.3. Në ngritjen e performancës rol të madhë luan disiplina dhe angazhimi serioz në punët ditore që ngarkohen operatorët e NJSO-ve. Në Ligjin për Policinë Nr. 04/ L-076 (2 mars 2012) Neni 43-Procedurat disiplinore për personelin policor, pika 1 thuhet: “të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës”.

3.3.4. Bazuar në analizat e bëra nga raportet vjetore të NJSO-ve, shihet se gjatë vitit 2012 numri i paraqitjes së rasteve dhe ndëshkimeve disiplinore në krahasim me vitin paraprak (2011) është afërsisht në të njëjtin nivel. Kështu, NJSO-ja në Prishtinë ka shënuar rënie të rasteve të paraqitura dhe masave disiplinore të shqiptuara⁸.

3.3.5. Nga të dhënat e raporteve të NJSO-ve, me rastet e iniciuara, për vitin 2012 me numër më të madh është NJSO në Mitrovicë me 13 raste e po ashtu prinë edhe me masa disiplinore të shqiptuara e që janë 8 masa disiplinore. Kurse, me numrin më të vogël të rasteve të iniciuara është Gjilani dhe po ashtu edhe me më pak masa të shqiptuara disiplinore, me vetëm dy prej tyre.

3.3.6. Një shqetësim që e ka përcjellë punën e NJSO-ve gjatë proceseve të angazhimit në raste të caktuara, ka qenë edhe mënyra e arrestimit të personave dhe mos përcjellja me një akt të duhur të arrestuarin prej momentit të arrestimit e deri tek dorëzimi i tij pjesëtarëve të tjerë të policisë. Në këtë pikë, NJSO-të kanë krijuar një formular unik për raste të tilla për të gjitha regjionet.

3.3.7. Gjatë inspektimit i është kushtuar vëmendje infrastrukturës apo objekteve se ku janë të vendosur këto njësi. Dallimi prej njësisë së Prishtinës dhe Mitrovicës me njësitë në rajonet tjera janë të dukshme. Përderisa këto dy njësi janë vendosur në lokacione të përshtatshme për veprim, njësitë në katër rajone tjera nuk kanë hapësirë dhe vend të përshtatshëm për t'i kryer detyrat dhe aktivitetet e tyre.

3.3.8. Ato nuk kanë palestra dhe mjete të duhura për ushtrime, iu mungojnë banjot për pastrim dhe dhomat e duhura për zhveshtore. Kjo gjendje e vendeve të punës ka krijuar pakënaqësi dhe demotivim të pjesëtarët e këtyre rajoneve, për shkak të favorizimit të dy njësisve kundrejt katër tjerave e që zakonisht janë në aksione me ta kur rrezikshmëria e këtyre aksioneve është e lartë.

⁸ Të dhënat nga raportet vjetore të NJSO-ve për vitin 2012

Në këtë drejtim, obligohet DNJS-ja që të krijojë hapësira dhe kushte adekuate për punë për të gjitha njësitë pa dallim regjioni.

3.3.9. NJSO-të si njësi elite të policisë janë të pajisura me armët më të mira dhe pajisjet e duhura për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Kjo për faktin se një performancë e mirë e tyre varet shumë edhe nga pajisjet që kanë në posedim, por edhe kujdesin ndaj tyre dhe vendin ku ato ruhen. NJSO-të armët e gjata janë të detyruara sipas parimeve dhe procedurave t'i mbajnë në vende të caktuara (armëtore) dhe mund të merren vetëm me urdhër të komandantit apo të autorizuarit të tij. Po ashtu, këto armë nuk duhet lënë asnjëherë pa mbikëqyrje (PSO, ne. 22).

3.3.10. Në disa regjione, sigurimi i vendeve për ruajtjen e armëve dhe paisjeve tjera ishte jo adekuat. Kështu, në regjionin e Ferizajit, Gjilanit, Prizrenit dhe Pejës armët dhe municioni ruhen në vende jo të përshtatshme, nuk janë të sistemuara si duhet dhe nuk kanë një listë të saktë të inventarizimit. Rasti i Ferizajit ishte shembulli më i keq ku në një zyrë jo të përshtatshme dhe të pa sistemuar mbahen armët, ndërsa siguria e tyre mbetet shqetësuese, ngase shpesh ngelin pa kurrfarë kujdesi kur ata largohen nga ato zyre, siç ishte edhe rasti kur ne vizituam këtë regjion.

3.3.11. Fakt tjetër shqetësues paraqitet mos inventarizimi në mënyrë të saktë dhe preciz i pajisjeve qoftë individuale dhe atyre të përbashkëta. Gjatë inspektimit nuk është has një formular i cili precizon saktë numrin e të gjitha paisjeve që posedon një NJSO Rajonale. Përveç kësaj, mungon një formular unik, për të gjitha regjionet ku do të regjistroheshin mënyra e menaxhimit të armëve dhe municionit. Përjashtim nga kjo bënë NJSO-ja në Mitrovicë, ku zbatimi i rregullave sipas PSO-së ishte strikt dhe fakt inkurajues edhe për regjionet tjera.

Rekomandimi nr. 8

Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që të krijohet një formë unike për të gjitha regjionet ku do të regjistrohen armët dhe pajisjet tjera në mënyrë të saktë dhe të bëhet inventarizimi i çdo pajisje që posedon secila njësi si (blerjet, donacionet, pajisjet me afat të skaduar, etj.).

3.3.12. Aktualisht, NJSO-të kanë në përbërjen e tyre armë Glock 9x19 mm si çdo pjesëtarë i Policisë së Kosovës, por për shkak të specifikave gjatë punës së tyre janë të pajisur edhe me AK-47, MP-5, UMP, armë automatike G36, si dhe Shot Gun. Pastaj, kanë mjete mbrojtëse si jeleka antiplumb, helmata, maska për mbrojtje nga gazi lotësjiellës, mburoja, etj. Po ashtu, janë të pajisur edhe me mjete motorike, ku përveç mjeteve të zakonshme transportuese kanë edhe automjetin për hedhjen e ujit (topin e ujit) si dhe autoblanda.

3.3.13. Në bazë të parimeve dhe procedurave që kanë të bëjnë me armatimin dhe pajisjet e NJSO-ve (ne. 21 pika C)⁹, nga të dhënat e siguruara në rajone del se në këtë pikë NJSO-të janë të furnizuara mirë dhe me të gjitha llojet e armëve që kërkohen. Kështu, NJSO-të në përgjithësi kanë këto lloje të armëve: AK 47, MP-5, UMP 5, G 36, Shot Gun, si dhe pushkë gjysmë automatike që i shfrytëzon garda në kuadër të NJSO-së në Prishtinë.

⁹ PSO e NJSO-ve, Pajisjet

3.3.14. Mjetet e blinduara (autoblindat), janë në kuadër të DNJS-së dhe përdorimi i tyre nga ana e NJSO-ve mund të bëhet vetëm pas vlerësimit të situatës, rrezikut që paraqitet dhe aprovimit të DNJS-së për përdorimin e tyre. Përndryshe, këto mjete mund të përdoren edhe nga njësitë tjera speciale, por gjithëherë me miratimin e DNJS-së.

3.3.15. IPK-ja ka gjetur edhe një numër të konsiderueshëm të disa pajisjeve të cilave u ka kaluar afati për përdorim. Kështu, antiplumba të kaltër taktik që nga viti 2004 janë gjithsejtë 227 pa afat, antiplumba të kaltër patrullues 315 po ashtu pa afat si dhe 552 copë sprej të mëdhenj pa afat e që ende kanë mbetur pjesë e NJSO-ve. IPK-ja vlerëson që DNJS-ja t'i rishikojë procedurat e zhvlerësimit dhe të shkarkimit të pajisjeve të cilat mbesin pa afat dhe t'ua dorëzoj ato organeve kompetente qoftë brenda policisë apo jashtë saj, në mënyrë që mos të mbeten barrë e panevojshme e NJSO-ve.

3.3.16. Ndërsa, gjatë analizimit të të dhënave janë gjetur një numër më i madh i disa pajisjeve, (p.sh.: helmata, antiplumba,) se sa që ka pjesëtarë në një njësi konkrete, p.sh.: regjioni i Mitrovicës është pajisur me 144 helmata të trazirave të reja, ndërsa ka pasur të tilla 80 dhe tërësisht funksionale. (Gjendje e njëjtë paraqitet edhe në Prizren, Ferizaj, etj.) Edhe këtu, DNJS-ja duhet ta rishikoj buxhetin për blerjen e pajisjeve vetëm aq sa duhen në mënyrë që t'iu ikin shpenzimeve të panevojshme për pajisjet që janë funksionale, ose nëse ka tepricë të tyre të shpërndahen tek njësitë tjera që mund t'u hyjnë në punë.

3.3.17. Për shkak të rolit specifik dhe mbështetës që NJSO-të i japin Policisë së Kosovës në tërësi këto njësi kryejnë një sërë aktivitete. Gjatë periudhës vjetore 2012 këto njësi kanë kryer në total 27,558 aktivitete. Ky numër tregon angazhimet e tyre duke filluar nga patrullimet, pikat e kontrollit, mbështetjet në planet operative të regjioneve, mbështetjen në planet operative të stacioneve policore, kontrollime me urdhëresë, asistime gjykatave, kuvendeve komunale, përcjellje, menaxhimin e protestave, operacione speciale, objekte të kontrolluara, përcjelljen e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë e aktivitete tjera të shumta të këtyre njësive.

3.3.18. Gjatë analizimit të numrit të aktiviteteve apo ngarkesës në punë vërehet se NJSO-ja Pejë, ka kryer më tepër aktivitete se sa regjionet tjera me 10,884 sosh, kurse NJSO-ja Ferizaj me më së pakti aktivitete me 1302.

3.3.19. Vlerësimi i performancës së policëve është një proces që ndodh vazhdimisht në NJSO-të bazuar në parime dhe procedura dhe rregulloren për vlerësim. Vlerësimi i tillë për pjesëtarët e NJSO-së rregullohet njëjtë si tek të gjithë pjesëtarët tjerë të Policisë së Kosovës dhe konkretisht parashihet me PSO-në me nr. DP-6.01¹⁰. Kjo procedurë parashih formular unik për të gjithë dhe zakonisht vlerësimi me të bëhet me nota nga 1-5. Gjithashtu, në të ka vend për komente shtesë nëse është e nevojshme.

3.3.20. Gjatë inspektimit në teren, lidhur me vlerësimin, menaxherët të cilët vlerësojnë stafin zakonisht iu ikin komenteve. Poashtu, edhe operatorët në përgjithësi nuk kanë shfaqur ankesa lidhur me vlerësimet e tyre nga stafi menaxhues duke deklaruar se përgjithësisht vlerësimet janë në nivel.

¹⁰ Vlerësimi i performancës, dt. Efektive 05.12.2008

4. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

4.1. Përfundimi

4.1.1 Sipas Ligjit të Policisë së Kosovës, Komandantët e Njësive Speciale Operative dhe menaxherët e lartë të DNJS-së, në fillim të vitit duhet të konsultohen mes veti për synimet e qarta, objektivat specifike për vitin vijues dhe në fund të vitit komandantët duhet t'i raportojnë strukturave kompetente të shtetit, si dhe organeve monitoruese të policisë lidhur me sukseset e tyre në arritjen e këtyre synimeve. Ky proces lë të kuptohet se synimet duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe reale.

4.1.2 Theksi i veçantë bie te procesi i ngadalshëm i reformës e që është një proces shumë i rëndësishëm për PK-në. Reforma dhe riorganizimi i zgjatur i NJSO-së ka krijuar një jo qëndrueshmëri në unifikimin e komandës, ngritjen e efikasitetit, zvogëlimin e burimeve njerëzore dhe demotivim të tyre si rezultat i mos planifikimit të duhur në arritjen e synimit për bërjen e reformës në afate të matshme kohore me qëllim që NJSO të jetë funksionale me kapacitet të plotë operativ.

4.1.3 Krijimi dhe funksionimi i NJRSH-ve në kuadër të DRP-ve të rregullohet nga Departamenti për Siguri Publike dhe të nxirren PSO-të e duhura për funksionimin e tyre, ngase çdo vonesë në krijimin e kornizave të duhura normative për funksionimin e tyre do të krijojë vështirësi në kryerjen e detyrave nga ana e tyre.

4.1.4 Reformat e bëra në NJSO të përcjellen në të ardhmen me trajnime adekuate dhe teste riçertifikuese ashtu si e parasheh PSO-ja e NJSO-ve duke mos lënë asnjë pjesëtarë të kësaj njësie pa këto trajnime si dhe të certifikohen trajnerë adekuat brenda njësisë që do të jenë të gatshëm çdo herë t'u japin rifreskim pjesëtarëve të NJSO-ve me trajnime, dhe të përcjellin në vazhdimësi nevojat për trajnime të NJSO-së.

4.1.5 Po ashtu, t'i jepet rëndësi inventarizimit të të gjitha pajisjeve dhe mjeteve motorike që disponon NJSO-ja si tërësi, dhe të parasheh formular identik për të gjitha njësitë në të cilët në mënyrë precize do të evidentohet çdo pajisje apo mjet motorik që disponon NJSO-ja, si dhe vendin e tyre se ku gjenden. Kjo krijon transparencë dhe mundësi të kontrollit të këtyre pajisjeve nga keq menaxhimi, manipulimi apo edhe humbja e tyre.

4.1.6 Së fundi, duke pasur parasysh natyrën e detyrave dhe përgjegjësive si dhe pajisjet që kanë në dispozicion NJSO-të, këto të fundit janë të gjykuara nga përceptimi i publikut të jenë në dukje më problematike, sesa njësitet tjera të sigurisë publike. Por, ky përceptim qytetar mund të balancohet dhe ndryshohet duke inspektuar dhe duke sjellë argumente se disa probleme që mund të rrjedhin nga praktikat aktuale të NJSO-ve, mund të rivlerësohen modifikohen dhe të përdoren praktikat më të mira për funksionimin e tyre.

4.2 Rekomandimet

IPK gjatë këtij inspektimi paraqet rekomandimet përmbledhëse si në vijim:

1. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që Divizioni i Njësive Speciale duhet të rishikoj PSO-në në fuqi që rregullon punën e NJSO-ve dhe ta harmonizoj me aktet ligjore në fuqi dhe ndryshimet organizative-strukturore që janë aprovuar për NJSO-të më 20.05.2012.*
2. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që procesi i stabilizimit të strukturës së menaxhimit brenda NJSO-së duhet të përshpejtohet dhe në këtë mënyrë të evitohen diferencat e mëdha në menaxhmentin e NJSO-së lidhur me shtrirjen e kontrollit dhe plotësimin e pozitave me grada adekuate.*
3. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin policor që gjatë implementimit të reformës për NJSO-të të angazhohet edhe për formimin e NJRSH-ve jo vetëm në aspektin strukturor por edhe atë praktik duke u përcjellur me aktet e nevojshme rregullative.*
4. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, fuqishëm menaxhmentin e PK-së që të filloj aplikimin e parimeve dhe procedurave të sigurimit shëndetësor për pjesëtarët e Njësive Speciale konform (PSO, ne.15), krijimin e kushteve të cilat duhet të përmbushen për zhvillimin e trajnimeve të domosdoshme (PSO, ne. 17.1).*
5. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që aftësitë dhe njohuritë individuale të fituara gjatë trajnimit, të vlerësohen përmes testeve standarde, në drejtim të rritjes së efikasitetit të performancës së NJSO-së.*
6. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, menaxhmentin e DNJS-së që të organizoj dhe mbaj trajnime për ri-certifikim të rregullt të trajnerëve, ri-certifikim sipas Parimit 8.14 si dhe rregullave të parapara për ri-certifikim me armë të gjata.*
7. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, Drejtorin e Divizionit të Njësive të Specializuara, edhe pse deri në fund të vitit 2014 pritet që të centralizohet kjo njësi (NJSO) vetëm në një strukturë unike, që në të ardhmen kurseve obligative t'u jipet prioritet në mënyrë që i gjithë personeli i NJSO-së të trajnohen.*
8. *Inspektorati Policor i Kosovës rekomandon, që të krijohet një formë unike për të gjitha regjionet ku do të regjistroheshin armët dhe pajisjet tjera në mënyrë të saktë dhe të bëhet inventarizimi i çdo pajisje që posedon secila njësi (blerjet, donacionet, pajisjet me afat të skaduar, etj.).*